



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:086097
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05575939

Ac.nr.1311/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson M.K., kundër të paditurit P.M. nga fshati, Komuna e Gjilanit, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.466/17, datë 17.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e të paditurit P.M. nga fshati, Komuna e Gjilanit, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.466/17 i datës 17.12.2019 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.466/17 të datës 17.12.2019, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë dhe Detyrohet i padituri P.M. nga fshati, Komuna e Gjilanit, që paditëses t'ia regresojë shumën prej 500.15 € (pesëqindë e pesëmbëdhjetë euro), në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 18.04.2018, me kamatë ashtu siç paguajnë Bankat në Kosovë mbi një vit pa destinim të veçantë, duke

llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet i padituri që paditëses t'ia kompensoj shumën e të hollave në lartësi prej 20 euro, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet ashtu që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses, ose që aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes përfaqësueses së autorizuar të saj, me datë 23.06.2017, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për rimbursimin e dëmit material dhe jomaterial, kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të: I. Miratohet kërkesëpadija e paditëses Byrosë Kosovare të Sigurimit në Prishtinë, si e bazuar, II. Detyrohet i padituri P.M., që paditëses Byrosë Kosovare të Sigurimit në Prishtinë t'ia rimbursojë shumën prej 515 €, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 18.04.2014 në Gjilan, me kamatë ligjore nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në ditën e pagesës përfundimtare, si dhe t'i paguaj edhe shpenzimet gjyqësore të cilat do t'i caktoj kjo gjykatë, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.466/17, të datës 17.12.2019, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: meqë për palët ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese përgjegjësia e të paditurit sa i përket aksidentit të datës 18.04.2014 dhe se i njëjti në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese, gjegjësisht i ka skaduar afati i policës së sigurimit, gjithashtu nuk ka qenë kontestuese se personit të tretë i është paguar dëmi në shumë prej 515 € dhe gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike dhe duke zbatuar nenin 18.1 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ku është paraparë humbja e mbulesës siguroese dhe kjo pikë e mbulesës siguroese ka paraparë se "Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronar i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkoj dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja", andaj në rastin konkret i padituri përkatësisht automjeti i tij i markës "... " me targa të regjistrimit nuk ka qenë i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive kurse është vërtetuar se i dëmtuari në rastin konkret ka bërë kërkesë për kompensimin e dëmit material ndërsa paditësja (BKS) e ka bërë pagesën e dëmit në shumë prej 515 €, kurse pika 4 e Ligjit dhe nenit të lartcekur ka paraparë se: "Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatën,". Në rastin konkret i padituri është vërtetuar se është përgjegjës për dëmin e paguar nga ana e paditëses

për personin e dëmtuar N.D. dhe nga këto arsye gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë si të bazuar dhe ka vendosur si në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar. Gjykata vendosi si në pikën II, të dispozitivit duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-ës, pasi që i padituri e ka humbur kontestin dhe për këto arsye gjykata e obligoi të paditurin që paditësit t'ia paguaj shumën prej 20 për taksën për paraqitjen e kësaj padie. Sa i përket pretendimeve të palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës konform dispozitive të LMD-së, gjykata ka konstatuar se në rastin konkret nuk kemi parashkrim të kërkesës për faktin se ujdia jashtëgjyqësorë është lidhur më dt.20.08.2014, ndërsa padia është paraqitur në gjykatë më datë 23 qershor 2107, çka do të thotë se padia është dorëzuar në afatin ligjor, ashtu siç përcaktohet me nenin 357 të LMD-së së vitit 2012.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 357 dhe 361 të LMD-së, 18 paragraf dhe 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, lidhur me nenin 142 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1, lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 dhe 356 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjer tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar ka të meta të atilla, për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitive materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka konstatuar se me fajin e kujt është shkaktuar ky aksident dhe se pjesëmarrësit në këtë aksident, a kanë kontribuar eventualisht në shkaktimin e këtij aksidenti, apo kemi të bëjmë me përgjegjësi ekskluzive të drejtuesit të automjetit të pa siguruar, pasi që i padituri gjatë shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit - gjegjësisht kontributin e pjesëmarrëseve në këtë aksident e në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë ekspertizë të komunikacionit që vërteton përgjegjësinë në shkaktimin e aksidentit apo kontributin eventual të pjesëmarrësve në këtë aksident. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes ka qenë dashur të caktoj nxjerrjen e provës me ekspertim nga lëmia e komunikacionit rrugor, duke caktuar me aktvendim të veçantë ekspertin nga lëmia përkatëse

dhe duke ia përshkruar saktë detyrat ekspertit në kuptim të nenit 356, 358, 361, 362, 363, 364 dhe 369 të LPK-së.

Për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, tani për tani vlerësohet se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në riprocedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve të sipër theksuara, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësoj kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, të caktoj shqyrtimin kryesor dhe sipas propozimit të palëve të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare. Fillimisht të konstatoj se në këtë rast a është kontestuese baza juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit, të marr në shikim shkresat e lëndës sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore të datës 20.08.2014, nëse edhe me tej mbetet kontestuese baza juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit, ta caktoj nxjerrjen e provës me ekspertim nga lëmia e komunikacionit rrugor, ta ftoj ekspertin për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e dhënë në ekspertizë dhe pas kësaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ashtu që përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses. Me rastin e vendosjes meritore, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të kujdeset që vendimin të cilin e merr, t'i përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Gjykata po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 paragraf 1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1311/20, me datë 04.04.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli